




REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT

MUNICIPALITY OF DEÇANI - OPSTINA DEÇANI



Drejtoria për Arsim në Deçan

Nr.07-Zyrtarisht

Datë:05.04.2018

Deçan

Në bazë të kërkesave të shkollave të komunës së Deçanit, konform dispozitave të nenit 8 pika 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave ligjore të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032 si dhe nenit 5 pika (c) të Ligjit nr.03/L-068 për Arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, Drejtoria për Arsim në Deçan, shpall :

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës në këto Institucione edukative Arsimore aftësuese në komunën e Deçanit.

I. SH.F.M.U. " Avni Rrustemi " në Rrezar (Irzniq).

1. Një mësimdhënës të lëndës së Gjuhës Angleze

II. SH.F.M.U. " Jusuf Gërvalla " në Prapaqan.

1. Një Mësues Klase .

III. SH.F.M.U. " Faik Konica " në Ratish.

1. Një Mësues Klase.

KUSHTET : Kandidatët e interesuar për konkurrim për të gjitha vendet e lira të punës duhet ti plotësojnë kushtet e parapara sipas Ligjit për Arsimin Parauniversitar , si dhe Udhëzimit Administrativ të MASHT-it ,nr.06/2015,të kenë kualifikimet përkatëse profesionale të kryera , për pozitën I nën 1 Fak. I Edukimit Bachelor i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, për pozitën II nën 1 Fak. i Edukimit Bachelor i Programit Fillor dhe për pozitën III nën 1 Fak, i Edukimit Bachelor i Programit Fillor.

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim :

- Çertifikata e lindjes (apo kurorëzimi për femrat e martuara),
- Kopja e letërnjoftimit,
- Diploma e shkollës së kryer në original apo e legalizuar dhe
- Vërtetimi për përvojën e punës në arsim.

Të drejtat dhe obligimet parashihen me kontratën e punës me rastin e punësimit..

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Drejtoratin për Arsim në Deçan.

Konkursi mbetet i hapur në afat kohor prej 8 ditësh nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik ditor.

DALESE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E DEÇANIT • OPSTINA DEÇANE • DEÇANI MUNICIPALITY

Nr. Prot. 10121
Dr. Arsimi
07
05.04.18
1 ng 201

DEÇAN DEÇANE

